



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



## HISTORI SUKSESI

### Angazhimi i shoqërisë civile në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm



*"Ideja e angazhimit të shoqërisë civile në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm është e pasur në përmbajtje dhe e rëndësishme për bashkërendimin e aktiviteteve si në radhët e shoqërisë civile brenda qytetit, ashtu edhe në nivel kombëtar".*

Vlora Gaxheri – Syri i Vizionit

Angazhimi i organizatave dhe aktivistëve të shoqërisë civile në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel komunal në Kosovë është qasje e rëndësishme në mënyrë që vendorët të merren me këtë çështje, duke u bazuar në aktivitetet e komunitetit.

Dhjetë (10) organizata të shoqërisë civile nga Peja, Mitrovica e Jugut, Gjilani, Ferizaj dhe Kaçaniku, së bashku me

“Qendrën për Studimin e Politikave të Sigurisë” dhe Koordinatorin Kombëtar për Zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimin që shpie në Terrorizëm 2015-2020, u mbledhën në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2016, në një Punëtori për Planifikimin e Aktiviteteve për vitin 2017 dhe të xhiros së parë të trajnimeve për OShC-të në nivel komunal për ekstremizmin e dhunshëm që shpie në terrorizëm.

Vlora Gaxheri është njëra nga aktivistet e shoqërisë civile nga Peja. Ajo punon me OJQ-në “Syri i Vizionit”, e cila – siç e përshkruan ajo – merret me mirëqenien e qytetarëve dhe është e gatshme ta japë kontributin e saj kurdo dhe kudo që të jetë e nevojshme.

*“Ekstremizmi i dhunshëm, ndonëse jo diçka e panjohur në vendin tonë, ende vazhdon të ngatërrohet me terrorizmin. Edhe pse mbetet kërcënim, ende nuk pranohet si çështje ekzistuese, ose heshtet kur identifikohet. Elementet e këntilla janë mjaft bindëse për të ndërmarrë hapa konkretë drejt parandalimit dhe luftimit të tij, në vendet ku dyshohet se ai po bëhet më i fuqishëm”,* thotë Vlora Gaxheri.

Ajo thekson domosdoshmërinë e aktiviteteve të komunitetit kundër ekstremizmit të dhunshëm në komunën e saj.

*“Komuna e Pejës nuk renditet si vend i rrezikut të madh nga ekstremizmi i dhunshëm, por fillimi i "lokalizimit" dhe i ngritjes së vetëdijes për pasojat dhe faktin se ekstremizmi nuk i sjell dobi askujt nuk është vetëm i nevojshëm, por tejet i nevojshëm në të vërtetë”,* thotë Gaxheri.

Projekti “Promovimi i angazhimit të shoqërisë civile në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm” realizohet nga ‘Qendra për Studimin e Politikave të Sigurisë’ (QSPS) dhe mbështetet nga programi Angazhimi për Barazi i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.